RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

SISTEMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË

ARKIVIN QENDROR SHTETËROR TË FILMIT

Tiranë, Tetor 2026

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 3
2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit 6
II. HYRJA 7
1. Objektivat dhe qëllimi 7
2. Identifikimi i çështjes 7
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 7
4. Përgjegjësitë e audituesve 7
5. Kriteret e vlerësimit 8
6. Standardet e auditimit 8
7. Metodat e auditimit 8
8. Dokumentimi i auditimit 8
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 9
1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim 9
2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit 9
2.1 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit 9
2.2 Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave 12
IV. REKOMANDIME 17

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, nga data 10.06.2026 deri në 15.07.2026.
Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. *Përshkrim i shkurtër për subjektin në auditim*

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit është person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet nga Ligjin nr. 8096 datë 29.04.1996 "Për kinematografinë", i ndryshuar, Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*"; Nenit 34 shkronjës "b" dhe Nenit 77 pikës 3 të Ligjit nr. 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", si dhe nga Rregullorja e Brendshme miratuar me Urdhërin e Ministrit nr. 527, datë 14.12.2020, "*Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit*". Si institucion i administratës shtetërore, AQSHF ka filluar të funksionojë në vitin 1997 si institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse të kulturës, pas shkëputjes nga ishKinostudio "*Shqipëria e re*". Kuadri normativ si më sipër, përcakton dhe misionin, objektivat dhe detyrat e AQSHFsë.
Misioni i AQSHF-së konsiston në mbrojtjen, restaurimin dhe vënien në dispozicion të publikut të fondit filmik kombëtar, si pjesë e trashëgimisë kulturore të vendit. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, institucioni zbaton politikat e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, edukimin kulturor, ruajtjen e traditave shqiptare, forcimin e dialogut kulturor dhe integrimin evropian.
Gjithashtu, AQSHF-ja është pjesë e organizatave dhe rrjeteve kombëtare e ndërkombëtare të fushës së filmit, zhvillon aktivitete për promovimin e kulturës filmike, dhe garanton respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

b. *Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij*

Rëndësia e këtij auditimi qëndron në faktin se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit është institucion publik buxhetor, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, me seli në Tiranë, i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe ka për qëllim ruajtjen, përpunimin, pasurimin dhe shfrytëzimin e materialeve arkivore filmike, në respekt të të drejtave të autorit, si dhe mbështetja e krijimit të veprave të reja artistike e studimore.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i auditimit bazuar në programin e auditimit është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të, për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Grupi i auditimit, në fazën e planifikimit, mblodhi informacion të përgjithshëm mbi subjektin nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave për identifikimin e zonave me risk të lartë, mbi bazën e të cilave u hartuan drejtimet e auditimit dhe kërkesat për informacion, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Metodat dhe teknikat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave janë përdorur veçmas ose të kombinuara, duke përfshirë: shqyrtimin e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe të dokumenteve mbi përdorimin e sistemeve

informatike; intervistat me personat përgjegjës; verifikimin teknik dhe analizimin e funksioneve të sistemit e të dhënave të eksportuara nga sistemet; si dhe rakordimin e informacionit të marrë nga subjekti me të dhënat publike të faqes zyrtare dhe evidencat teknike. Të dhënat e grumbulluara u vlerësuan përballë kritereve ligjore, rregullative dhe standardeve ndërkombëtare (ISSAI 5300, ISSAI 5310, ISO/IEC 27001), me qëllim formimin e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve mbi bazën e një evidence të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme audituese.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga auditimi rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 7 gjetje dhe ka dhënë 7 rekomandime.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit nuk ka në strukturën e tij organizative një punonjës të dedikuar për ushtrimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë nxjerrë asnjë urdhër, vendim apo akt tjetër administrativ, nëpërmjet të cilit të jetë caktuar zyrtarisht personi ose struktura përgjegjëse për administrimin, koordinimin dhe ushtrimin e funksioneve të TIK-ut në institucion.

Për rrjedhojë, përgjegjësitë për administrimin dhe menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nuk janë të përcaktuara dhe të formalizuara qartë, duke krijuar paqartësi lidhur me përgjegjësinë për administrimin e infrastrukturës TIK, si dhe zbatimin e masave të nevojshme për sigurinë e informacionit.

Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike"*, ndryshuar me Ligjin nr. 100, datë 12.9.2024 dhe nr. 25/2026, datë 20.2.2026, në të cilin kërkohet përcaktimi i qartë i përgjegjësive për administrimin dhe menaxhimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Nga auditimi mbi sistemet e operimit në 11 kompjuterët në funksion, rezultoi se:

- 6 kompjuterë operojnë me sistemin Windows 11, version aktualisht me mbështetje nga prodhuesi (Microsoft);
- 4 kompjuterë operojnë me sistemin Windows 10, për të cilin suporti standard i prodhuesit ka përfunduar më 14 tetor 2025; pas kësaj date, Microsoft nuk ofron më përditësime sigurie apo përmirësime për këtë version;
- 1 kompjuter operon me sistemin Windows 7, version për të cilin përditësimet e sigurisë janë ndërprerë prej kohe nga prodhuesi.

Gjithashtu, u konstatua se 2 kompjuterët e Sektorit të Restaurimit dhe Dixhitalizimit, ku kryhen të gjitha proceset audiovizuale të institucionit, operojnë me Windows 10.

Kombinimi i pajisjeve jashtë mbështetjes dhe pa mbrojtje antivirus përbën risk të lartë infektimi, i cili mund të përhapet edhe në kopjet rezervë nëse ato shkruhen nga një sistem i kompromentuar, duke rrezikuar fondin kombëtar të trashëgimisë kulturore audiovizuale që administron institucioni. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*", i ndryshuar, përsa i përket standardeve të sigurisë së infrastrukturës TIK, si dhe me standardin ISO/IEC 27001.

- Nga auditimi u konstatua se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit disponon një pajisje NAS me kapacitet 80 TB, e cila është marrë në dorëzim nga Ministria e Kulturës më datë 25.01.2022 dhe vlerë fillestare 1,464,000 lekë.

Pajisja ka qenë funksionale për vitin 2022, ndërsa në vitet në vijim nuk ka qenë në përdorim. Punonjësit e institucionit deklaruan se përdorimi i saj është ndërprerë me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për arsye sigurie. Gjatë auditimit, institucioni nuk

paraqiti urdhër, udhëzim, shkresë apo dokument tjetër zyrtar që të vërtetojë kërkesën apo vendimmarrjen për ndërprerjen e përdorimit të saj.
Bazuar në të dhënat kontabël rezulton se, pajisja është amortizuar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës dhe deri më 31.12.2022, vlera e mbetur e saj është **1,128,500 lekë**.
Investimi për pajisjen NAS në vlerën 1,464,000 lekë, nuk është shfrytëzuar plotësisht për qëllimin dhe përfitimin e synuar.
Gjithashtu, fakti që pajisja nuk është përdorur që prej vitit 2023, krijon riskun e humbjes së mëtejshme të vlerës ekonomike dhe funksionale të këtij aktivi. Në veçanti, komponentët hardware dhe disqet e ruajtjes së të dhënave i nënshtrohen vjetërsimit teknologjik edhe gjatë mospërdorimit, duke rritur riskun që investimi të mos shfrytëzohet në të ardhmen pa kryer shpenzime shtesë për mirëmbajtje, zëvendësim ose përditësim.
Njëkohësisht, mosshfrytëzimi i kapacitetit prej 80 TB kufizon mundësinë e institucionit për të organizuar një skemë të plotë dhe të qëndrueshme të kopjeve rezervë (backup), duke rritur riskun lidhur me ruajtjen, disponueshmërinë dhe rikuperimin e të dhënave.
Sa më sipër, mosshfrytëzimi i pajisjes NAS përbën përdorim joefektiv të investimit publik, me vlerë kontabël të mbetur prej 1,128,500 lekësh më datë 31.12.2022, periudhë në të cilën është ndërprerë përdorimi i saj.

- Nga auditimi i procesit të ruajtjes dhe të kopjeve rezervë të materialeve filmike u konstatua se institucioni realizon arkivimin nëpërmjet teknologjisë LTO, me frekuencë mujore, duke mbajtur tri kopje të pavarura në dy lloje pajisjesh, të cilat ruhen të gjitha pranë ambienteve të AQSHF-së. Mosplotësimi i kushtit të ruajtjes në dy vendndodhje fizike të ndryshme e lë fondin e dixhitalizuar të ekspozuar ndaj ngjarjeve si zjarr, përmbytje apo vjedhje, e cila mund të sjellë humbjen njëkohësisht të të tria kopjeve.

Gjithashtu, nuk u vu në dispozicion asnjë procedurë e shkruar për verifikimin e integritetit të kopjeve dhe as evidencë e dokumentimit të rezultateve të testimeve; nuk janë dokumentuar kushtet mjedisore të ambientit ku mbahen kasetat LTO, konkretisht temperatura dhe lagështia relative; dhe nuk mbahet regjistër i kasetave LTO me datën e prodhimit, gjeneratën dhe ciklin e rifreskimit. Për rrjedhojë, institucioni nuk disponon të dhëna të verifikueshme mbi gjendjen reale të kopjeve rezervë dhe nuk mund të planifikojë migrimin e të dhënave përpara skadimit të jetëgjatësisë së mediave.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se AQSHF nuk ka hartuar dhe miratuar një rregullore për ruajtjen e të dhënave, në të cilën të përcaktohet se cilat kategori të dhënash dhe materialesh elektronike ruhen, për sa kohë, në çfarë formati dhe kush është përgjegjës për ruajtjen e tyre, duke mos garantuar një proces të formalizuar dhe të kontrollueshëm.
Kjo situatë nuk është në përputhje me standardin ISO/IEC 27001, përsa i përket kopjeve rezervë dhe vazhdimësisë së veprimtarisë, si dhe me rekomandimet e Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmit (FIAF), "*The Digital Statement: Recommendations for digitization, restoration, digital preservation and Access"*, të cilat kërkojnë ruajtjen e kopjeve në vendndodhje të ndara, dokumentimin e kushteve të ruajtjes, mbajtjen e regjistrit të mediave dhe verifikimin periodik të integritetit të kopjeve.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të marrë masa për t'iu drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, me qëllim caktimin, nëpërmjet një akti administrativ, të strukturës ose specialistit përgjegjës për administrimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse.
- Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të hartojë dhe zbatojë një plan konkret veprimi për heqjen nga përdorimi ose përditësimin e 5 pajisjeve me sisteme operimi jashtë mbështetjes së prodhuesit, duke i dhënë përparësi pajisjeve të Sektorit të Restaurimit dhe Dixhitalizimit. Gjithashtu, të mbahet një inventar i përditësuar

i pajisjeve informatike me evidentimin e versioneve të sistemeve të operimit dhe të datave të përfundimit të mbështetjes nga prodhuesi.

- Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrë masa për dokumentimin zyrtar të statusit të pajisjes NAS dhe të arsyeve të ndërprerjes së përdorimit të saj, si dhe të vlerësojë mundësinë e rikthimit të saj në përdorim, në përputhje me kërkesat dhe standardet e sigurisë së informacionit.

Në rast se rikthimi në përdorim nuk është i mundur ose nuk rezulton i përshtatshëm, institucioni të marrë masa për përcaktimin e destinacionit të mëtejshëm të pajisjes, në përputhje me rregullat për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, duke synuar ruajtjen e vlerës së mbetur të investimit dhe shmangien e zhvlerësimit të mëtejshëm të tij.

- Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit të hartojë dhe miratojë një rregullore për ruajtjen e të dhënave, ku të përcaktohen kategoritë e materialeve, afatet dhe formatet e ruajtjes, si dhe përgjegjësitë përkatëse; të krijojë regjistrin e kasetave LTO me datën e prodhimit, gjeneratën dhe ciklin e rifreskimit; të vendosë monitorimin dhe regjistrimin periodik të temperaturës e të lagështisë relative në ambientin e ruajtjes; si dhe të përcaktojë një procedurë të shkruar për verifikimin periodik të integritetit të kopjeve rezervë, me dokumentimin e rezultateve të çdo testimi.

Gjithashtu, institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrë masa për sigurimin e një vendndodhjeje të dytë fizike, të ndarë gjeografikisht nga ambientet aktuale, për ruajtjen e së paku një kopjeje të fondit të dixhitalizuar.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", bazuar në gjetjet e auditimit, vlerësojmë se në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit nevojitet përmirësimi i kuadrit organizativ e teknik të teknologjisë së informacionit, me qëllim garantimin e ruajtjes afatgjatë të trashëgimisë kinematografike kombëtare. Institucioni ushtron veprimtarinë e tij mbi një infrastrukturë bazike, pa sisteme të mirëfillta të teknologjisë së informacionit, pa punonjës të dedikuar për funksionet TIK dhe pa një pikë kontakti me AKSHI-n për sigurinë e informacionit, ndërkohë që rregullorja e brendshme e vitit 2020 nuk është përditësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 43/2023 dhe të Ligjit nr. 124/2024. Përdorimi i sistemeve të operimit jashtë mbështetjes së prodhuesit në rreth 45% të pajisjeve, mungesa e programit antivirus në kompjuterët ku kryhen proceset e dixhitalizimit, ruajtja e të gjitha kopjeve rezervë në një vendndodhje të vetme fizike dhe mosvënia në përdorim e pajisjes NAS, rrisin ekspozimin ndaj rreziqeve të sigurisë dhe cenojnë garantimin e ruajtjes afatgjatë të fondit të dixhitalizuar. Këto mangësi marrin peshë të shtuar duke pasur parasysh se institucioni është kujdestari ligjor i trashëgimisë kinematografike kombëtare, humbja ose dëmtimi i së cilës do të ishte i pariparueshëm.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të programit nr. 621/1 prot., datë 10.06.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.06.2026 deri më datë 15.07.2026, në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjëse grupi;
2. A. A., anëtar;
3. S. D., anëtare.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, nga data 10.06.2026 deri më datë 15.07.2026. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, mbrojnë informacionin; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe mbështeten në kontrolle të duhura.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Ky auditim ka si objekt vlerësimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025.

Si drejtime të auditimit në programin me nr. 621/1 prot., datë 10.06.2026, janë identifikuar drejtimet në vijim:

1. Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
2. Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit është person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet nga Ligjin nr. 8096 datë 29.04.1996 "*Për kinematografinë*", i ndryshuar, Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*"; Nenit 34 shkronjës "b" dhe Nenit 77 pikës 3 të Ligjit nr. 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*".

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 deri në 31.12.2025, në drejtim të teknologjisë së informacionit, që është në përdorim dhe i shërben institucionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 621/1 prot., datë 10.06.2026 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit të teknologjisë së informacionit si dhe legjislacionin e fushës në të cilën operon AQSHF. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar marrjen e masave, për përmirësimin e situatës.

Kriteret ligjore, rregullative dhe standardet mbi të cilat është mbështetur auditimi, janë si më poshtë:

- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji nr. 124, datë 19.12.2024, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
- Ligji nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*";
- Ligji nr. 8096 datë 29.04.1996 "*Për kinematografinë*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike"*, ndryshuar me Ligjin nr. 100, datë 12.9.2024 dhe nr. 25/2026, datë 20.2.2026.
- Ligji nr. 25/2024 "*Për Sigurinë Kibernetike*";
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali i Auditimit IT si dhe Standardet Ndërkombëtare ISO27001, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, ISO 27001, etj.

7. Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit dhe akteve të brendshme si: rregullore, politika, procedura, marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata të TI-së;
- Intervistat me personelin kyç të subjektit dhe me strukturat përgjegjëse;
- Verifikimi i konfigurimeve dhe i masave teknike e organizative të sigurisë;
- Teknika me ndihmën e kompjuterit për ekzaminimin e faqes zyrtare të internetit.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara nga skanime;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF) është institucioni kombëtar i specializuar për ruajtjen, administrimin, restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë kinematografike shqiptare. Ai ka si mision të mbrojë dhe të transmetojë për brezat e ardhshëm pasurinë audiovizive të vendit, duke siguruar që filmat dhe materialet filmike të ruhen në kushte profesionale dhe të jenë të aksesueshme për studiuesit, institucionet dhe publikun.

Arkivi administron një fond të pasur filmik që përfshin filma artistikë, dokumentarë, kronika filmike, filma vizatimorë, si dhe materiale të tjera audiovizive të prodhuara në Shqipëri. Një pjesë e rëndësishme e këtij fondi vjen nga prodhimet e ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", e cila ishte institucioni kryesor i prodhimit kinematografik në vend nga viti 1952 deri në fillim të viteve 1990. AQSHF është kujdestari ligjor i kësaj trashëgimie, e cila përfshin materiale që datojnë që nga viti 1947.

Përveç ruajtjes së materialeve filmike, Arkivi zhvillon vazhdimisht projekte për restaurimin dhe digjitalizimin e filmave të vjetër. Këto procese kanë si qëllim rikthimin e cilësisë origjinale të filmave dhe mbrojtjen e tyre nga dëmtimi fizik, duke përdorur teknologji moderne si restaurimi në formatin 4K. Falë këtyre projekteve, shumë filma klasikë shqiptarë janë rikthyer në cilësi të lartë dhe janë bërë të disponueshëm për shfaqje publike dhe aktivitete kulturore.

Në fondet e AQSHF-së ruhen gjithashtu skenarë, fotografi nga xhirimet, postera, dokumente administrative, materiale promocionale dhe koleksione të tjera që lidhen me historinë e kinemasë shqiptare. Këto materiale përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për studiuesit, studentët, regjisorët dhe historianët e kulturës.

Si institucion publik, AQSHF organizon shfaqje filmash, ekspozita, aktivitete edukative dhe bashkëpunime me institucione kombëtare e ndërkombëtare për promovimin e trashëgimisë filmike shqiptare. Gjithashtu, ai ofron shërbime për qytetarët dhe studiuesit që kërkojnë të konsultojnë materiale arkivore, në përputhje me legjislacionin për arkivat dhe rregullat e institucionit.

2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit


2.1 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Në zbatim të pikës 1, të Programit të Auditimit nr. 621/1, datë 10.06.2026, u shqyrtua, si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Statuti i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 720,datë 24.10.2022, protokolluar në AQSHF me shkresën nr. 5935/1, datë 31.10.2022;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, miratuar me urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 527, datë 14.12.2020;
- Faqja web e Arkivit Qendror Shtetëror i Filmit;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës, etj.

Për kryerjen e funksioneve institucionale Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 136, datë 28.03.2014 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit"*, protokolluar në AQShF me nr. 58 prot., datë 01.04.2014 e cila është e ndërtuar mbi bazën e 2 Sektorëve me varësi direkte me Drejtorin e Përgjithshëm.

Diagrama 1: Organograma e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit



Burimi:AQShF, përpunuar nga grupi i auditimit

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit ka një strukturë me 10 punonjës.

Tabela 1: Struktura e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit

Nr.	Pozicioni	Nr. i punonjësve
Drejtori		1
Sektori i Redaksisë		3
	Specialist	3
Sektori i restaurimit, Dixhitalizimit, dhe Teknikes		6
	Specialist (Inxhinier Dixhitalizimi, Restaurimi Dixhital dhe Teknikës)	1
	Specialist (Inxhinier Kimist & Restaurimi Filmik)	1
	Magazinier/Kinomekanikë	1
	Tenik i mesëm	3
Totali		10

Burimi: AQShF, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi u konstatua se, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit nuk ka në strukturën e tij organizative një punonjës të dedikuar për ushtrimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Gjithashtu, nuk rezulton të jetë nxjerrë asnjë urdhër, vendim apo akt tjetër administrativ, nëpërmjet të cilit të jetë caktuar zyrtarisht personi ose struktura përgjegjëse për administrimin, koordinimin dhe ushtrimin e funksioneve të TIK-ut në institucion.
Për rrjedhojë, përgjegjësitë për administrimin dhe menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nuk janë të përcaktuara dhe të formalizuara qartë, duke krijuar paqartësi lidhur me përgjegjësinë për administrimin e infrastrukturës TIK, si dhe zbatimin e masave të nevojshme për sigurinë e informacionit.
Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*", i ndryshuar, i cili kërkon përcaktimin e qartë të përgjegjësive për administrimin dhe menaxhimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Rregullorja e brendshme
Me Urdhrin e Ministrit nr. 527, datë 14.12.2020, është miratuar Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm. Në Kreun IX të kësaj rregulloreje parashikohen dispozitat që rregullojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit, ku konkretisht:

- **Neni 30** - Komunikimin i brendshëm me rrjetin informatik;
- **Neni 31** - Rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike;
- **Neni 32** - Posta Elektronike.

Nga auditimi u konstatua se rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të AQSHF-së, e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 527, datë 14.12.2020, nuk është

përditësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*", i ndryshuar. Kreu IX i saj, specifikisht në nenet 30–32, i ngarkon administrimin e rrjetit dhe të pajisjeve një "specialisti IT" që nuk parashikohet në strukturën e institucionit (neni 3), i ngarkon administrimin e faqes zyrtare një funksioni redaksional pa kompetencë teknike (neni 8/f), lejon përdorimin e postës elektronike private për komunikim zyrtar (nenet 23/2 dhe 30/2), ndalon filet e bashkëlidhur në postën elektronike (neni 32/4), i referohet një ligji të shfuqizuar për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 32/10), dhe e rregullon ciklin e akteve administrative ekskluzivisht në formë fizike (Kreu V), pa njohur dokumentin elektronik, nënshkrimin dhe vulën elektronike. Rregullorja nuk përmban asnjë dispozitë për ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet "e-Albania", për standardet qeveritare të TIK-ut, për ruajtjen e të dhënave, apo për ndarjen e përgjegjësive me AKSHI-n.


Auditimi i faqes zyrtare të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit

Nga auditimi i faqes zyrtare të internetit të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit https://aqshf.gov.al/, u konstatuan disa mangësi në lidhje me zbatimin e detyrimeve për publikimin e informacionit sipas Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*",si dhe përditësimeve në përputhje me kërkesat e VKM nr. 782, datë 18.12.2024, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike", si më poshtë:

- Në faqen zyrtare të institucionit është publikuar programi i transparencës, së bashku me të dhënat e personit të kontaktit. Megjithatë, u konstatua se ky dokument nuk ka marrë miratimin përfundimtar nga drejtuesit e institucionit, pavarësisht se është përcjellë për miratim nga specialisti përgjegjës që në vitin 2018. Mungesa e miratimit formal të programit të transparencës është në kundërshtim me nenin33, 34, 35 te rregullores se brendshme si dhe me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, i cili kërkon miratimin dhe përditësimin e rregullt të programit nga organi drejtues i institucionit;
- Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e Programit të Transparencës së AQSHF-së u konstatua se rubrika "*Programi i Transparencës*" në faqen zyrtare të institucionit nuk është plotësuar me informacionin dhe dokumentacionin që kërkohet, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "*Për të drejtën e informimit*", si dhe nenet 33, 34, 35 te rregullores së brendshme. Gjatë auditimit konstatuam se në të gjitha kategoritë e informacionit të Programit të Transparencës mungon publikimi i informacionit, konkretisht në rubrikat: Kuadri ligjor; E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar; Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi autoritetin publik; Informacioni mbi buxhetin dhe të dhënat financiare; Informacioni për dhënien e mendimeve lidhur me procesin e hartimit të akteve nënligjore; Sistemi i administrimit të dokumentacionit;
- Nga auditimi i kryer mbi *Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve* të AQSHF-së u konstatua se në faqen zyrtare të institucionit nuk është publikuar regjistri sipas formatit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe ai nuk është plotësuar me informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "*Për të Drejtën e Informimit*".
- Menyja "*Transparenca*" nuk ka kategorizim sipas kërkesave të programit të transparencës, përcaktuar nga Ligji nr. 119/2014, duke vështirësuar aksesin efektiv të publikut në kategori informacioni, që bëhen publik si buxheti, prokurimet apo vendimmarrja institucionale;
- Faqja "*Rreth nesh*" përmban përmbajtje të pa përfunduar dhe të pa zëvendësuar me informacion real, përfshirë tekst demonstrativ në gjuhën latine (lorem ipsum), të dhëna stafi fiktive, dhe statistika institucionale me vlerë "0", si dhe materiale reklamuese të vetë temës Word Press të mbetura në faqe, këto mangësi tregojnë se përmbajtja e faqes zyrtare nuk është

administruar dhe përditësuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 782, datë 18.12.2024, "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike*".

Figura 1: Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të internetit të AQSHF-ë



Burimi: Testimi i audituesit në datën 23.06.2026

Për sa më sipër, nga auditimi i faqes zyrtare të internetit të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit u konstatua se institucioni nuk ka siguruar zbatimin e plotë të detyrimeve ligjore lidhur me transparencën institucionale. Konkretisht, Programi i Transparencës nuk është miratuar nga titullari i institucionit dhe nuk është përditësuar me informacionin e detyrueshëm; rubrika "*Transparenca"* nuk është organizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", gjithashtu përmbajtja e faqes zyrtare nuk është administruar dhe përditësuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 782, datë 18.12.2024, "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike*".

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbi rekomandimet e përcjella me Projektaportin shkresa me nr. 621/2 Prot, datë 09.09.2026, nga subjekti i audituar është shprehur pranimi i rekomandimeve dhe marrja e masave, paraqitur me shkresën nr. 621/3, datë 07.10.2026.

2.2 Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave

Në zbatim të pikës 2 "*Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave"*, u shqyrtua, si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Ligji nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
- Statuti i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 720, datë 24.10.2022, protokolluar në AQSHF me shkresën nr. 5935/1, datë 31.10.2022;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, miratuar me urdhrin e Ministrit të Kulturës nr.527, datë 14.12.2020;
- Guidelines nga FIAF – Federata Ndërkombëtare e Arkivave të Filmit: The Digital Statement: Recommendations for digitization, restoration, digital preservation and Access;

- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës, etj.

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit funksionon në bazë të një infrastrukture bazike dhe nuk ka në përdorim sisteme të mirëfillta të teknologjisë së informacionit. Nuk ka dokumentacion rregullues për Teknologjinë e Informacionit, përveç rregullores së dërguar për zbatim nga AKSHI me nr.1, datë 16.06.2023 për përdorimin e postës elektronike në administratën publike. Gjithashtu, institucioni nuk ka ndërveprime me institucione dhe sisteme të tjera. Në portalin e-Albania, institucioni ofron 5 shërbime dhe ndërvepron direkt me aplikantin pa kërkuar dokumentacion nga institucione të tjera. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit nuk ka kapacitete teknike në strukturën e tij dhe nuk ka një pikë kontakti me AKSHI-n, që të jetë përgjegjës për sigurinë e informacionit.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, versionet e Sistemit Operative për 11 kompjuterë të vendosur në funksion, (7 desktop dhe 4 laptop) në infrastrukturën e AQSHF-së, situata rezultoi si më poshtë:

- 6 kompjuterë operojnë me sistemin Windows 11, version aktualisht me mbështetje nga prodhuesi (Microsoft);
- 4 kompjuterë operojnë me sistemin Windows 10, për të cilin suporti standard i prodhuesit ka përfunduar më 14 tetor 2025; pas kësaj date, Microsoft nuk ofron më përditësime sigurie apo përmirësime për këtë version;
- 1 kompjuter operon me sistemin Windows 7, version për të cilin përditësimet e sigurisë janë ndërprerë prej kohe nga prodhuesi.

Për sa më sipër, 5 nga 11 kompjuterët (rreth 45% e infrastrukturës së kontrolluar) operojnë aktualisht me sisteme operative që kanë përfunduar ciklin jetësor "end-of-life", nuk marrin përditësime të sigurisë nga prodhuesi që është Microsoft. Kjo situatë përbën një rrezik të lartë për sigurinë e informacionit në AQSHF, pasi:

- Dobësitë e reja (vulnerabilitete) që zbulohen për këto sisteme nuk korrigjohen më nga prodhuesi, duke i lënë këto pajisje të ekspozuara ndaj sulmeve kibernetike (malware, ransomware);
- Rrezikohet integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave që përpunohen ose ruhen në këto pajisje, përfshirë dokumentacionin arkivor dhe administrativ të institucionit;
- Pajisjet me sisteme të pambështetura mund të shërbejnë si pikë hyrjeje (entry point) për përhapjen e kërcënimeve drejt pjesës tjetër të rrjetit institucional, duke vënë në rrezik edhe kompjuterët me sisteme të përditësuara (Windows 11).

2 kompjuterët e Sektorit të restaurimit e dixhitalizimit, ku kryhen të gjitha proceset audiovizuale të institucionit, operojnë me Windows 10. Kombinimi i pajisjeve EOL dhe pa mbrojtje, përbën një risk të lartë infektimi që mund të përhapet edhe në kopjet e backup-it nëse ato shkruhen nga një sistem i kompromentuar për fondin kombëtar të trashëgimisë kulturore audiovizuale që ka dhe krijon Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit.

Infrastruktura e ruajtjes së materialeve filmike që siguron arkivimin, mbrojtjen dhe aksesin afatgjatë të të dhënave audiovizuale, realizohet përmes teknologjisë LTO (Linear Tape-Open), e cila konsiderohet një nga zgjidhjet më të qëndrueshme dhe ekonomike për arkivimin afatgjatë të vëllimeve të mëdha të të dhënave, falë kapacitetit të lartë të ruajtjes, qëndrueshmërisë fizike dhe kostos relativisht të ulët për njësi të dhënash. Në LTO ruhen skanime ose digjitalizimi nga negativi i 35mm në format 4K të dixhitalizuara.

Krahas kasetave LTO, përdoren gjithashtu memorie të jashtme lokale (hard disk-e të jashtëm, pajisje USB me kapacitet të madh, etj.), të cilat shërbejnë si mjete plotësuese për ruajtjen, transferimin dhe backup-in e materialeve filmike.

Vazhdimësia e veprimtarisë dhe procedurat e kopjeve rezervë përbëjnë elemente thelbësore për mbrojtjen e integritetit dhe disponueshmërisë së materialeve filmike ndaj dëmtimit, humbjes apo dështimit teknik. Nga auditimi u konstatua se institucioni realizon arkivimin nëpërmjet teknologjisë LTO (Linear Tape-Open), me frekuencë mujore, duke ruajtur në kaseta LTO skanimet dhe dixhitalizimet e kryera nga negativi 35mm në format 4K.

Praktika e ndjekur nga institucioni është tre kopje të pavarura, në dy lloje pajisjesh. Nga auditimi u konstatua se kushti i tretë, ai i ruajtjes në dy vendndodhje fizike të ndryshme, nuk plotësohet, pasi të gjitha kopjet ruhen pranë ambienteve të AQSHF-së. Kjo e lë fondin e dixhitalizuar të ekspozuar ndaj një ngjarjeje si: zjarr, përmbytje, ndërprerje e energjisë me dëmtim pajisjesh apo vjedhje, e cila mund të sjellë humbje të të tre kopjeve. Duke qenë se këto të dhëna janë të fondit kombëtar të trashëgimisë kinematografike, materiale të cilat në një pjesë të konsiderueshme nuk janë të riprodhueshme, pasoja e një ngjarjeje të tillë do të ishte e pariparueshme.

Lidhur me verifikimin e integritetit të kopjeve, nga auditimi u konstatua se testimi nuk kryhet mbi bazën e një procedure të përcaktuar. Nga intervistat me personat përgjegjës rezultoi se leximi i kasetave kryhet herë pas here, sipas gjykimit të punonjësit dhe kryesisht në rastet kur materiali kërkohet për përdorim, dhe konsiderohet nga institucioni si testim i kopjes. Ky veprim nuk mbështetet në një frekuencë të përcaktuar, nuk mbulon një kampion të përfaqësuar të fondit të arkivuar, nuk shoqërohet me verifikim të shumave të kontrollit (checksum) për të vërtetuar identitetin bit-për-bit të kopjes me origjinalin, dhe rezultatet e tij nuk dokumentohen. Për rrjedhojë, institucioni nuk disponon asnjë evidencë të verifikueshme mbi gjendjen reale të kopjeve rezervë, as mbi aftësinë e tij për të realizuar një rikuperim të plotë në rast nevoje. Dëmtimi i heshtur i të dhënave ("*bit rot"*), i cili është karakteristik për mediat magnetike me kalimin e kohës, mund të mbetet i pazbuluar deri në momentin kur kopja kërkohet për rikuperim.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se nuk janë dokumentuar kushtet mjedisore të ambientit ku mbahen kasetat LTO, konkretisht temperatura dhe lagështia relative, të cilat janë përcaktuese për jetëgjatësinë reale të mediave magnetike. Njëkohësisht, nuk mbahet regjistër i kasetave LTO, në të cilin të evidentohen data e prodhimit, gjenerata e teknologjisë, data e shkrimit të të dhënave, përmbajtja dhe cikli i rifreskimit të secilës kasetë. Mungesa e këtij regjistri e bën të pamundur planifikimin e migrimit të të dhënave përpara skadimit të jetëgjatësisë së mediave ose përpara daljes nga përdorimi të gjeneratës përkatëse të pajisjeve të leximit, çka përbën një risk konkret për aksesueshmërinë afatgjatë të fondit.
Ndonëse ruajtja e të dhënave kryhet në praktikë, nga auditimi u konstatua se AQSHF nuk ka hartuar dhe miratuar një rregullore për ruajtjen e të dhënave, në të cilën të përcaktohet se cilat kategori të dhënash dhe materialesh elektronike ruhen, për sa kohë, në çfarë formati, me çfarë frekuence krijohen kopjet rezervë dhe kush është përgjegjës për ruajtjen e verifikimin e tyre. Për rrjedhojë, i gjithë procesi mbështetet në praktika të pashkruara dhe në njohuritë individuale të punonjësve, duke mos garantuar një proces të formalizuar, të vazhdueshëm dhe të kontrollueshëm.

Nga auditimi u konstatua se rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të AQSHF-së, e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 527, datë 14.12.2020, nuk përmban një kuadër të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale. E vetmja referencë ligjore që përmban është neni 32/10 që i drejtohet një ligji të shfuqizuar me nr. 9887/2008 dhe jo Ligjit aktual nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit disponon një pajisje NAS me kapacitet 80 TB, e cila është marrë në dorëzim më datë 25.01.2022, me vlerë fillestare 1,464,000 lekë.

Bazuar në komunikimin zyrtar të institucionit për të dhënat financiare, vlera kontabël e mbetur dhe amortizimi i akumuluar i pajisjes paraqiten si më poshtë:

Tabela 1: Vlera e mbetur dhe amortizimi për NAS

Viti	Vlera e mbetur (në lekë)	Amortizimi i akumuluar (në lekë)
2022	1,128,500	335,500
2023	846,375	617,625
2024	634,781	829,219
2025	476,086	987,914

Burimi: Të dhëna nga AQSHF

Pajisja është pjesë e një grupi pajisjesh elektronike të prokuruara nga Ministria e Kulturës në vitin 2021, me fonde të vëna në dispozicion të Ministrisë së Kulturës nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.
Nga auditimi rezultoi se pajisja deri në vitin 2022 ka qenë funksionale dhe prej këtij viti, nuk është më në përdorim. Punonjësit e institucionit deklaruan se përdorimi i saj është ndërprerë për arsye sigurie me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni. Megjithatë, gjatë auditimit institucioni nuk paraqiti urdhër, udhëzim, shkresë apo dokument tjetër zyrtar që të vërtetojë kërkesën e AKSHI-t apo vendimmarrjen lidhur me ndërprerjen e përdorimit të pajisjes.
Pavarësisht investimit publik të kryer në vlerën fillestare 1,464,000 lekë, pajisja nuk është shfrytëzuar për qëllimin për të cilin është siguruar. Për rrjedhojë, investimi nuk ka realizuar plotësisht qëllimin dhe përfitimin e synuar.
Nga viti 2023 e në vijim dhe në kushtet e mospërdorimit, vlera e mbetur e këtij aktivi në vitin 2025 rezulton të jetë 476,086 lekë.
Në veçanti, komponentët hardëare dhe disqet e ruajtjes së të dhënave i nënshtrohen vjetërsimit teknologjik edhe gjatë mospërdorimit, duke rritur riskun që investimi të mos mund të shfrytëzohet në të ardhmen pa kryer shpenzime shtesë për mirëmbajtje, zëvendësim ose përditësim. Njëkohësisht, mosshfrytëzimi i kapacitetit prej 80 TB kufizon mundësinë e institucionit për të organizuar një skemë të plotë dhe të qëndrueshme të kopjeve rezervë (backup), çfarë rrit riskun për ruajtjen, disponueshmërinë dhe rikuperimin e të dhënave.


Sa më sipër, mosshfrytëzimi i pajisjes NAS prej vitit 2023 e në vijim përbën përdorim joefektiv të një investimi publik me vlerë fillestare 1,464,000 lekë, dhe me vlerë kontabël të mbetur 1,128,500 lekë më datë 31.12.2022.

Institucioni administron të dhëna personale të punonjësve, të aplikantëve për shërbimet e ofruara nëpërmjet portalit e-Albania, si dhe të studiuesve e qytetarëve që kërkojnë konsultimin apo aksesimin e materialeve arkivore, çfarë e bën të detyrueshëm zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 124, datë 19.12.2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave.

Nga auditimi u konstatua se, në përgjigje të kërkesave për informacion, institucioni nuk vuri në dispozicion asnjë dokument që të provonte marrjen e masave për zbatimin e Ligjit nr.124/2024, i cili ka shfuqizuar Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar. Konkretisht, nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit asnjë akt i brendshëm, analizë apo evidencë tjetër që të dëshmonte identifikimin e kategorive të të dhënave personale që administrohen dhe përpunohen, të subjekteve të të dhënave, të qëllimeve dhe bazave ligjore të përpunimit, apo të masave teknike e organizative të marra për mbrojtjen e tyre. Në dispozicion të grupit të auditimit nuk u vendos asnjë urdhër i titullarit për caktimin e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nuk rezultoi të jetë kryer

njoftimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nuk janë publikuar të dhënat e kontaktit në faqen zyrtare.
AQSHF nuk ka hartuar dhe miratuar politika të privatësisë, në të cilat të përcaktoheshin qëllimet dhe bazat ligjore të përpunimit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe procedura e trajtimit të kërkesave e të ankesave. Në faqen zyrtare të internetit nuk është publikuar asnjë njoftim privatësie për vizitorët, ndonëse faqja disponon formular kontakti, ndërsa formularët e aplikimit për shërbimet arkivore nuk shoqërohen me informimin paraprak të subjektit të të dhënave.

Figura 2: Pamje nga faqja zyrtare e internetit www.aqshf.gov.al/kontakt



Burimi: Testim si vizitor i faqes në datën 14.07.2026

Gjithashtu, rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 527, datë 14.12.2020, nuk përmban një kuadër të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale; e vetmja referencë e saj është neni 32/10, i cili bazohet në Ligjin nr. 9887/2008, të shfuqizuar. Mospërditësimi i saj pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.124/2024 tregon se institucioni nuk ka reflektuar në aktet e veta të brendshme detyrimet e kuadrit të ri ligjor.

Bazuar në sa më sipër, nga auditimi u konstatua se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit nuk ka caktuar Nëpunësin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nuk ka marrë masa për përmbushjen e kërkesave të tjera të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, duke filluar me identifikimin e të dhënave personale që administron, përpunon apo kontrollon institucioni.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbi rekomandimet e përcjella me Projektaportin me shkresën nr. 621/2 Prot, datë 09.09.2026, nga subjekti i audituar është shprehur pranimi i rekomandimeve dhe marrja e masave, paraqitur me shkresën nr. 621/3, datë 07.10.2026.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit nuk ka në strukturën e tij organizative një punonjës të dedikuar për ushtrimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë nxjerrë asnjë urdhër, vendim apo akt tjetër administrativ, nëpërmjet të cilit të jetë caktuar zyrtarisht personi ose struktura përgjegjëse për administrimin, koordinimin dhe ushtrimin e funksioneve të TIK-ut në institucion.
Për rrjedhojë, përgjegjësitë për administrimin dhe menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nuk janë të përcaktuara dhe të formalizuara qartë, duke krijuar paqartësi lidhur me përgjegjësinë për administrimin e infrastrukturës TIK, si dhe zbatimin e masave të nevojshme për sigurinë e informacionit.
Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike"*, ndryshuar me Ligjin nr. 100, datë 12.9.2024 dhe nr. 25/2026, datë 20.2.2026, në të cilin kërkohet përcaktimi i qartë i përgjegjësive për administrimin dhe menaxhimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të marrë masa për t'iu drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, me qëllim caktimin, nëpërmjet një akti administrativ, të strukturës ose specialistit përgjegjës për administrimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr.527, datë 14.12.2020, nuk është përditësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*", i ndryshuar. Kreu IX i saj, specifikisht në nenet 30–32, i ngarkon administrimin e rrjetit dhe të pajisjeve një "*specialisti IT"* që nuk parashikohet në strukturën e institucionit (neni 3), i ngarkon administrimin e faqes zyrtare një funksioni redaksional pa kompetencë teknike (neni 8/f), lejon përdorimin e postës elektronike private për komunikim zyrtar (nenet 23/2 dhe 30/2), ndalon filet e bashkëlidhur në postën elektronike (neni 32/4), i referohet një ligji të shfuqizuar për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 32/10), dhe e rregullon ciklin e akteve administrative ekskluzivisht në formë fizike (Kreu V), pa njohur dokumentin elektronik, nënshkrimin dhe vulën elektronike. Rregullorja nuk përmban asnjë dispozitë për ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet "e-Albania", për standardet qeveritare të TIK-ut, për ruajtjen e të dhënave, apo për ndarjen e përgjegjësive me AKSHI-n.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm, për harmonizimin e saj me legjislacionin në fuqi në fushën e qeverisjes elektronike, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
Gjithashtu, të përcaktohen qartë përgjegjësitë për administrimin dhe koordinimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe të parashikohen rregulla për përdorimin e dokumentit elektronik, nënshkrimit elektronik dhe vulës elektronike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se faqja zyrtare e internetit të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, nuk ka siguruar zbatimin e plotë të detyrimeve ligjore lidhur me transparencën institucionale. Konkretisht, Programi i Transparencës nuk është miratuar nga titullari i institucionit dhe nuk është përditësuar me informacionin e detyrueshëm; rubrika "*Transparenca"* nuk është organizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", gjithashtu përmbajtja e faqes zyrtare nuk është administruar dhe përditësuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 782, datë 18.12.2024, "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, të marrë masa për përmirësimin dhe garantimin e zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e transparencës institucionale, duke miratuar dhe përditësuar Programin e Transparencës nga titullari i institucionit, në përputhje me kërkesat ligjore për të drejtën e informimit.
Gjithashtu, të merren masa për riorganizimin dhe përditësimin e rubrikës "*Transparenca*" në faqen zyrtare të internetit, duke siguruar publikimin e plotë dhe në kohë të informacionit të detyrueshëm, si dhe administrimin e përmbajtjes së faqes zyrtare në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë rregullat për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemet e operimit në 11 kompjuterët në funksion, rezultoi se:
- 6 kompjuterë operojnë me sistemin Windows 11, version aktualisht me mbështetje nga prodhuesi (Microsoft);
- 4 kompjuterë operojnë me sistemin Windows 10, për të cilin suporti standard i prodhuesit ka përfunduar më 14 tetor 2025; pas kësaj date, Microsoft nuk ofron më përditësime sigurie apo përmirësime për këtë version;
- 1 kompjuter operon me sistemin Windows 7, version për të cilin përditësimet e sigurisë janë ndërprerë prej kohe nga prodhuesi.

Gjithashtu, u konstatua se 2 kompjuterët e Sektorit të Restaurimit dhe Dixhitalizimit, ku kryhen të gjitha proceset audiovizuale të institucionit, operojnë me Windows 10.
Kombinimi i pajisjeve jashtë mbështetjes dhe pa mbrojtje antivirus përbën risk të lartë infektimi, i cili mund të përhapet edhe në kopjet rezervë nëse ato shkruhen nga një sistem i kompromentuar, duke rrezikuar fondin kombëtar të trashëgimisë kulturore audiovizuale që administron institucioni. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*", i ndryshuar, përsa i përket standardeve të sigurisë së infrastrukturës TIK, si dhe me standardin ISO/IEC 27001.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të hartojë dhe zbatojë një plan konkret veprimi për heqjen nga përdorimi ose përditësimin e 5 pajisjeve me sisteme operimi jashtë mbështetjes së prodhuesit, duke i dhënë përparësi pajisjeve të Sektorit të Restaurimit dhe Dixhitalizimit. Gjithashtu, të mbahet një inventar i përditësuar i pajisjeve informatike me evidentimin e versioneve të sistemeve të operimit dhe të datave të përfundimit të mbështetjes nga prodhuesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të ruajtjes dhe të kopjeve rezervë të materialeve filmike u konstatua se institucioni realizon arkivimin nëpërmjet teknologjisë LTO, me frekuencë mujore, duke mbajtur tri kopje të pavarura në dy lloje pajisjesh, të cilat ruhen të gjitha pranë ambienteve të AQSHF-së. Mosplotësimi i kushtit të ruajtjes në dy

vendndodhje fizike të ndryshme e lë fondin e dixhitalizuar të ekspozuar ndaj ngjarjeve si zjarr, përmbytje apo vjedhje, e cila mund të sjellë humbjen njëkohësisht të të tria kopjeve.
Gjithashtu, nuk u vu në dispozicion asnjë procedurë e shkruar për verifikimin e integritetit të kopjeve dhe as evidencë e dokumentimit të rezultateve të testimeve; nuk janë dokumentuar kushtet mjedisore të ambientit ku mbahen kasetat LTO, konkretisht temperatura dhe lagështia relative; dhe nuk mbahet regjistër i kasetave LTO me datën e prodhimit, gjeneratën dhe ciklin e rifreskimit. Për rrjedhojë, institucioni nuk disponon të dhëna të verifikueshme mbi gjendjen reale të kopjeve rezervë dhe nuk mund të planifikojë migrimin e të dhënave përpara skadimit të jetëgjatësisë së mediave.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se AQSHF nuk ka hartuar dhe miratuar një rregullore për ruajtjen e të dhënave, në të cilën të përcaktohet se cilat kategori të dhënash dhe materialesh elektronike ruhen, për sa kohë, në çfarë formati dhe kush është përgjegjës për ruajtjen e tyre, duke mos garantuar një proces të formalizuar dhe të kontrollueshëm.
Kjo situatë nuk është në përputhje me standardin ISO/IEC 27001, përsa i përket kopjeve rezervë dhe vazhdimësisë së veprimtarisë, si dhe me rekomandimet e Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmit (FIAF), "*The Digital Statement: Recommendations for digitization, restoration, digital preservation and Access"*, të cilat kërkojnë ruajtjen e kopjeve në vendndodhje të ndara, dokumentimin e kushteve të ruajtjes, mbajtjen e regjistrit të mediave dhe verifikimin periodik të integritetit të kopjeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit të hartojë dhe miratojë një rregullore për ruajtjen e të dhënave, ku të përcaktohen kategoritë e materialeve, afatet dhe formatet e ruajtjes, si dhe përgjegjësitë përkatëse; të krijojë regjistrin e kasetave LTO me datën e prodhimit, gjeneratën dhe ciklin e rifreskimit; të vendosë monitorimin dhe regjistrimin periodik të temperaturës e të lagështisë relative në ambientin e ruajtjes; si dhe të përcaktojë një procedurë të shkruar për verifikimin periodik të integritetit të kopjeve rezervë, me dokumentimin e rezultateve të çdo testimi.
Gjithashtu, institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrë masa për sigurimin e një vendndodhjeje të dytë fizike, të ndarë gjeografikisht nga ambientet aktuale, për ruajtjen e së paku një kopjeje të fondit të dixhitalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit nuk ka caktuar Nëpunësin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nuk ka ndërmarrë masa për përmbushjen e kërkesave të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*". Në përgjigje të kërkesave për informacion, institucioni nuk vuri në dispozicion asnjë dokument që të provonte identifikimin e kategorive të të dhënave personale që administron dhe përpunon, hartimin e politikave të privatësisë, apo përcaktimin e masave organizative për mbrojtjen e të dhënave.
Institucioni administron të dhëna personale të punonjësve, të aplikantëve për shërbimet e ofruara nëpërmjet portalit e-Albania, si dhe të studiuesve e qytetarëve që kërkojnë konsultimin e materialeve arkivore, çfarë e bën të detyrueshëm zbatimin e kërkesave të ligjit në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit të kryejë identifikimin e kategorive të të dhënave personale që administron dhe përpunon, të subjekteve të të dhënave, të qëllimeve e bazave ligjore të përpunimit, si dhe të hartojë e miratojë politikat e privatësisë dhe rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.
Gjithashtu, në cilësinë e autoritetit publik, institucioni të marrë masa për caktimin me urdhër të titullarit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe publikimin e të dhënave të

kontaktit të tij në faqen zyrtare, si dhe të njoftojë caktimin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE DHE TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit disponon një pajisje NAS me kapacitet 80 TB, e cila është marrë në dorëzim nga Ministria e Kulturës më datë 25.01.2022 dhe vlerë fillestare 1,464,000 lekë.
Pajisja ka qenë funksionale për vitin 2022, ndërsa në vitet në vijim nuk ka qenë në përdorim. Punonjësit e institucionit deklaruan se përdorimi i saj është ndërprerë me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për arsye sigurie. Gjatë auditimit, institucioni nuk paraqiti urdhër, udhëzim, shkresë apo dokument tjetër zyrtar që të vërtetojë kërkesën apo vendimmarrjen për ndërprerjen e përdorimit të saj.
Bazuar në të dhënat kontabël rezulton se, pajisja është amortizuar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës dhe deri më 31.12.2022, vlera e mbetur e saj është **1,128,500 lekë**.
Investimi për pajisjen NAS në vlerën 1,464,000 lekë, nuk është shfrytëzuar plotësisht për qëllimin dhe përfitimin e synuar.
Gjithashtu, fakti që pajisja nuk është përdorur që prej vitit 2023, krijon riskun e humbjes së mëtejshme të vlerës ekonomike dhe funksionale të këtij aktivi. Në veçanti, komponentët hardware dhe disqet e ruajtjes së të dhënave i nënshtrohen vjetërsimit teknologjik edhe gjatë mospërdorimit, duke rritur riskun që investimi të mos shfrytëzohet në të ardhmen pa kryer shpenzime shtesë për mirëmbajtje, zëvendësim ose përditësim.
Njëkohësisht, mosshfrytëzimi i kapacitetit prej 80 TB kufizon mundësinë e institucionit për të organizuar një skemë të plotë dhe të qëndrueshme të kopjeve rezervë (backup), duke rritur riskun lidhur me ruajtjen, disponueshmërinë dhe rikuperimin e të dhënave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrë masa për dokumentimin zyrtar të statusit të pajisjes NAS dhe të arsyeve të ndërprerjes së përdorimit të saj, si dhe të vlerësojë mundësinë e rikthimit të saj në përdorim, në përputhje me kërkesat dhe standardet e sigurisë së informacionit.
Në rast se rikthimi në përdorim nuk është i mundur ose nuk rezulton i përshtatshëm, institucioni të marrë masa për përcaktimin e destinacionit të mëtejshëm të pajisjes, në përputhje me rregullat për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, duke synuar ruajtjen e vlerës së mbetur të investimit dhe shmangien e zhvlerësimit të mëtejshëm të tij.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT